

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”
FAKULTETI I EDUKIMIT
PROGRAMI PARASHKOLLOR



PUNIM DIPLOME

Valentina Kajtazi

Mitrovicë, 2019

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”
FAKULTETI I EDUKIMIT
PROGRAMI PARASHKOLLOR



PUNIM DIPLOME

METODAT INOVATIVE TË
MËSIMDHËNIES NË EDUKIMIN
PARASHKOLLOR

Mentorja:

Prof.Ass.Dr.Edita Bekteshi

Kandidatja:

Valentina Kajtazi

Mitrovicë,2019

UNIVERSITY OF MITROVICA “ ISA BOLETINI”
FACULTY OF EDUCATION
PRESCHOOL EDUCATION DEPARTMENT



BACHELOR THESIS

**INNOVATIVE TEACHING METHODS IN
PRESCHOOL EDUCATION**

Thesis Supervisor:
Prof.Ass.Dr.Edita Bekteshi

Student:
Valentina Kajtazi

Mitrovicë,2019

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”
FAKULTETI I EDUKIMIT
PROGRAMI PARASHKOLLOR



PUNIM DIPLOME

Lënda:	Gjuhë angleze
Titulli i punimit:	Metodat inovative të mësimdhënies në edukimin parashkollor
Emri dhe mbiemri:	Valentina Kajtazi
Statusi i studentit:	I rregullt
Numri i amzës (ID Regjistri):	1506021046
Niveli i studimeve:	Bachelor
Programi i studimit:	Parashkollor
Mentori/ja i/e punimit:	Prof.Ass.Dr.Edita Bekteshi

Aprovuar prej komisionit:

1. /Emri Mbiemri, Titulli/ _____, mentor
2. /Emri Mbiemri, Titulli/ _____, anëtar
3. /Emri Mbiemri, Titulli/ _____, anëtar

Data e aprovimit: _____

Deklaratë e autorësisë

Unë, Valentina Kajtazi, deklaroj në përgjegjësi dhe ndërgjegje të plotë që në këtë punim i gjithë informacioni është marrë dhe paraqitur në bazë të rregullave akademike dhe sjelljes etike, dhe është rezultat i punës sime të pavarur.

Poashtu deklaroj se bazuar në këto kërkesa dhe rregulla e kam cituar të gjithë materialin e huazuar nga puna e autorëve të tjerë.

FALËNDERIME

Nuk do ishte e lehtë të arrija këtë sukses pa ndihmën e personave që më mbështetën vazhdimisht, që më këshilluan dhe më ndihmuan përgjatë këtij rrugëtimi katër vjeçarë të studimeve Bachelor.

Falënderoj pafundësisht familjen time të dashur, e cila më përkrahu në çdo hap timin, ishin shtylla më e fortë për arritjen e sukseseve të mia. Gjithashtu falënderoj, të gjithë stafin profesional të profesorëve të Fakultetit të Edukimit Parashkollor në Universitetin e Mitrovicës, për angazhimin dhe kontributin e tyre gjatë gjithë këtyre katër viteve të studimeve, e në veçanti profesoreshën time mentore Prof.Dr. Edita Bekteshi, e cila me gadishmëri dhe profesionalizëm më shoqëroi gjatë këtij punimi. Mbështetje dhe vullnet të madh pata edhe nga shoqëria ime e çmueshme, andaj i falënderoj përzemërsisht të gjithë që më qëndruan pranë.

DEDIKIM

Këtë punim i'a dedikoj familjes sime të dashur, e në veçanti personit më të shenjtë të jetës sime, nënës.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	VI
ABSTRACT.....	VII
1. HYRJE	1
1.1 Edukimi parashkollor dhe rëndësia e tij	2
1.1.1 Kuptimi i metodave të mësimdhënies në edukimin parashkollor	3
1.1.2 Roli i mësimdhënies në edukimin parashkollor	5
1.2 Metoda tradicionale e mësimdhënies	6
1.2.1 Përparësitë dhe dobësitë e metodës tradicionale.....	8
1.3 Metoda bashkëkohore e mësimdhënies.....	9
1.3.1 Metodologjia “fëmija në qendër”	10
1.4 Çka është inovacioni?	11
1.4.1 Roli i inovacionit në arsim	12
1.4.1 Metodatat inovative të mësimdhënies në edukimin parashkollor.....	13
1.4.2 Përdorimi i metodave innovative të mësimdhënies	14
2. METODOLOGJIA	16
3. DISKUTIME	17
3.1 Teknologjia multimediale	17
3.2 Mësimdhënia krijuese	19
3.3 Luajtja e roleve	20
3.4 Klasat jashta klasës	21
3.5 Kopshtet pyjore	22
4. KONLUDIME DHE REKOMANDIME	25
5. REFERENCAT	27

LISTA E FIGURAVE

<i>Figura 1: Zhvillimi i procesit mësimor me anë të mjeteve teknologjike.....</i>	18
<i>Figura 2: Fëmijët në luajtjen e rolit të mjekut dhe pacientit</i>	21
<i>Figura 3: Aktivitet në kopshtet pyjore.....</i>	Error! Bookmark not defined.

ABSTRAKT

Në arsim, angazhimi i fëmijëve i referohet shkallës së vëmendjes, kuriozitetit, interesit, optimizmit dhe pasionit që tregojnë fëmijët kur mësojnë diçka, gjë që varet nga mënyra e motivimit që ju bëhet atyre dhe nga përdorimi i metodave, të cilat ndikojnë në pjesëmarrjen aktive të tyre. Me përdorimin e metodave inovative nga ana e edukatoreve, fëmijët inkurajohen të marrin pjesë në aktivitet praktikë, inovuese të cilat i realizojnë në bashkëveprim me moshatarët e tyre. Fëmijët janë ata të cilët kërkojnë mënyra aktive në marrjen e njohurive dhe jo vetëm të ulen dhe të marrin njohuritë nga një ligjeratë ose disa fleta pune, siç ndodhë në mësimdhënien tradicionale. Kur ata janë të angazhuar në procesin mësimor, ata mësojnë dhe mbajnë në mend më shumë. Ky punim është realizuar në atë mënyrë që të mirren informacione të nevojshme nga shqyrtimi i hulumtimeve të ndryshme, të cilat studiojnë të njëjtën çështje. Qëllimi i këtij punimi ishte të vlerësojë dhe paraqesë metodat tradicionale dhe bashkëkohore të mësimdhënies midis së cilave bëhen edhe krahasime, si dhe të ofrojë shembuj të ndryshëm të metodave inovative, të cilat kanë një ndikim pozitiv në realizimin e procesit mësimor. Përdorimi i teknologjisë në insitucionet parashkollore ofron mundësi e mira për të krijuar ide të reja dhe inovuese, ku përmes pajisjeve teknologjike mund zhvillohen aktivitete të ndryshme dhe mësohet përmes tyre. Përveç kësaj, edhe mësimdhënia krijuese, luajtja e roleve dhe realizimi i procesit mësimor në ambiente të hapura, përbëjnë disa nga metodat inovative të cilat sjellin benifite të mëdha tek fëmijët parashkollor. Është e nevojshme që edhe në vendin tonë të bëhet një hulumtim me tematik të tillë, të shohim se sa praktikohen metodat inovative në shkolla dhe kopshtet tona, si dhe sa prej aktiviteteve i realizojnë fëmijët në ambiente të hapura.

***Fjalët kyqe:** Edukatore, fëmijë, metoda inovative, mësimdhënie, edukim parashkollor*

ABSTRACT

In education, children's engagement is referred to attention level, curiosity, interest, optimism and passion that children show, while they learn something which depends from the way we motivate them from the usage of methods which influence in their active participation. By the usage of innovative methods of the teacher side children are encouraged to participate in practice activities, innovative which they realize in relation with their mates. Children are the ones who ask in active way knowledge and not just to sit and get knowledge from a lesson or some paper work, as in traditional teaching. While they are engaged in the lesson process they use to remember more. This paper work is realized in order to get some real necessary information by the review of different researches, which study the same case. The purpose of this work was to estimate and show traditional and modern methods of teaching between which are made comparisons, as well offering enough examples of innovative methods which influence positively in the teaching process. The use of technology in preschools offers good opportunities to create new ideas and innovative, where technological devices can develop and learn different activities. Apart this, creative teaching and teaching process, role playing and learning in open environment contain one of the most innovative methods which bring major benefits to the primary school children. It is necessary that in one country to make similar research with the same subject in order to figure out how much such innovative methods are practiced in one school and kindergarten and thus see how much activities children succeed in an open environment.

Key words: *Educator, children, innovation methods, teaching, preschool education*

1.HYRJJE

“Mësuesi – edukatori ka një model pune. Planifikimi i metodave dhe i teknikave të mësimdhënies së avancuar, është pjesë e këtij modeli, ai ndihmon për të krijuar një disiplinë korrekte, atmosferë të këndshme dhe veprimtari të qëllimshme mësimore, pa intervale të vdekura dhe lëvizje të kota. Planifikimi i mësimdhënies konsiston në moton: të vendosësh se çfarë do të arrish, si t’ia arrish dhe si të tregosh se çfarë është arritur”.

William Edward Burghard Du Bois (1868-1963)

Një institucion parashkollor i mirëfilltë është ai institucion i cili realizon suksesshëm procesin edukativ, siguron mirërritjen e fëmijëve si dhe zhvillimin e tyre në të gjitha fushat e zhvillimit.

Edukimi parashkollor (ang.Preschool education) në një mënyrë është një formë arti, i cili i mundëson fëmijëve të shprehin imagjinatën (ang. imagiantion) dhe kreativitetin (ang.creativity) e tyre. Ndërsa një mësues parashkollor nuk është më pak se një artist dhe shtylla kurrizore e gjithë sistemit parashkollor, i cili përmes metodave të ndryshme mësimore organizon tërë veprimtarinë e procesin mësimor. Mësimdhënësi/ja e edukimit parashkollor udhëheqë një grup fëmijësh, të cilëve ju ofron mundësi dhe ua përmbushë të gjitha nevojat e tyre, duke i mësuar ata për aftësitë themelore të jetës. Edukimi parashkollor nuk është i drejtuar vetëm në kryerjen e detyrave rutinore (ang.routine tasks), por ai gjithashtu përfshinë edhe shumë subjektivitet nga ana e edukatoreve. Si rezultat i këtij subjektiviteti, në të gjithë botën mësimi/edukimi parashkollor ka zhvilluar metoda të ndryshme të mësimdhënies, metoda këto të cilat na ofrojnë mundësi të kuptojmë stilet e ndryshme të mësimdhënies (Verma, 2017).

Duke u nisur nga fakti se vitet e para të jetës janë vitet ku fëmijët zhvillohen në mënyrë të shpejtë dhe intensive, formësohen shprehitë e tyre dhe krijohen modelet për gjithë jetën, rëndësi të madhe në këtë periudhë ka edhe aplikimi i metodave të përshtatshme ndaj nevojave, interesave dhe moshës së fëmijëve. Zhvillimi dhe modernizimi i metodave të reja inovative, ofron mundësi më të mira në mësim si dhe krijon kushte më të përshtatshme për realizimin e veprimtarive mësimore. Prandaj, ky punim ka për qëllim që nëpërmjet shqyrtimit të literaturës së gjuhës angleze të ofrojë

shembuj të ndryshëm të metodave mësimore inovative, të cilat do të ndikonin pozitivisht edhe në edukimin parashkollor në vendin tonë.

Inovacioni (ang.innovation) e ka kuptimin e një ideje të re, një risie, metode apo edhe mendimi krijues të cilat në arsim zbatohen në formë të metodave të mësimdhënies (ang.methods of teaching). Inovacioni në arsim do të thotë të bësh atë që është më e mira për të gjithë fëmijët. Edukatorja, mësimet dhe kurrikula duhet të jenë sa më fleksibile, ndërsa fëmijët duhet të nxiten që të jenë më kurioz dhe të bëjnë sa më shumë pyetje. Me përdorimin e metodave inovative në mësim, atyre ju ofrohen mundësi më të mira për ti mbajtur më të interesuar në mësim.

Sipas Michele, “Inovacioni në arsim është gjithmonë duke kërkuar njohuri që mbështesin ide të reja dhe unike (ang.new and unique ideas) në teknikat mësimore që do të arrijnë te fëmijët në mënyra më efektive dhe emocionuese” (Universiteti Concordia-Poland, 2019). Suksesi i metodave të reja të mësimdhënies varet nga aftësia e edukatoreve për të shpikur dhe zbatuar metoda inovative të mësimdhënies. Roli i arsimit është të ofrojë fëmijë të aftë dhe inovues në fuqinë punëtore. Përdorimi i metodave inovative në institucionet arsimore ka potencial jo vetëm për të përmirësuar arsimin, por edhe për të fuqizuar njerëzit, forcuar qeverisjen dhe për të arritur qëllimin e zhvillimit njerëzor për vendin.

1.1. Edukimi parashkollor dhe rëndësia e tij (Preschool education and its importance)

Edukimi parashkollor (ang.Preschool Education) është një proces që synon përvetësimin e diturive dhe shkathtësive të çdo individi pa marrë parasysh dallimet individuale, nivelin e panjohurive dhe shkathtësive që fëmijët mund t'i kenë. Asnjë fëmijë nuk është i ngjashëm dhe asnjë fëmijë nuk kërkon të njëjtën masë kujdesi, prandaj në përmbushjen e të gjitha nevojave të tyre dhe në ofrimin e mundësive që të gjithë fëmijët të bëhet të pavarur në veprimtaritë e tyre është Edukimi Parashkollor.

Sipas Kosovo Education and Employment Network – KEEN (2018), edukimi parashkollor në Kosovë, paraqet nivelin e parë të arsimit parauniversitar i cili organizohet në institucione parashkollore publike, private, qendrat me bazë në Komitetet dhe klasat parafillore në institucione shkollore. Në të përfshihen të gjithë

fëmijët e moshës 0-6 vjeç. Përkundër faktit që edukimi parashkollor vlerësohet të jetë baza që përcakton suksesin e fëmijëve në shkollimin e mëtutjeshëm, në vendin tonë ky nivel i arsimit nuk është trajtuar me seriozitet në politikat arsimore. Kjo më së miri dëshmohet me sfidat me të cilat përballet edukimi parashkollor në Kosovë, përfshirë mungesën e institucioneve parashkollore në vend, ku vetëm 23 nga 34 komuna të Kosovës kanë së paku një kopsht publik të fëmijëve deri në moshën 6 vjeçare, ndërsa numri i institucioneve parashkollore publike është edhe më i vogël me vetëm 42 institucione parashkollore publike në mbarë vendin. Po ashtu edhe mungesa e infrastrukturës së përshtatshme për moshën e fëmijëve, mungesa e materialeve didaktike dhe materialeve shpenzuese të cilat nevojiten për organizimin e aktiviteteve janë disa nga çështjet të cilat nuk janë trajtuar mjaftueshëm (KEEN, 2018).

Sipas Ligjit për Edukimin Parashkollor nr. 02/L-52, vijimi i edukimit parashkollor në Kosovë është vullnetar dhe e drejtë e çdo fëmije deri në regjistrimin e tyre në klasë të parë. Me miratimin e këtij ligji, gradualisht u vendosën shtyllat për një edukim më të organizuar dhe më cilësor. Ky ligj, përcaktoi qartë, qëllimin e edukimit parashkollor, parimet mbi bazën e të cilave do të organizohej edukimi parashkollor, organizimin dhe përmbajtjen e edukimit parashkollor publik dhe privat, financimin, të punësuarit në institucionet parashkollore, mbrojtjen e të dhënave dhe deri tek mbikëqyrja e punës (Kuvendi i Kosovës, 2006).

Si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit dhe ligjit për edukimin parashkollor, në vitin 2006 është hartuar edhe dokumenti i “Standardeve të përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor (3-6 vjeç) në Kosovë” dhe dokumenti i “Kurrikulës së edukimit parashkollor (3-6 vjeç) në Kosovë”, të cilat paraqesin politikat e para për edukimin parashkollor në vendin tonë.

1.1.1 Kuptimi i metodave të mësimdhënies në edukimin parashkollor (Understanding teaching methods in preschool education)

Në procesin mësimor të mësimdhënies, është dhe mbetet problem i madh përdorimi i metodave sa më efikase të punës me fëmijë, çështje kjo e cila ka një rëndësi të veçantë pasi që ato na shoqërojnë në tërë ecurinë e procesit mësimor.

Fjala metodë është fjalë greke (methodos), në gjuhën shqipe do të thotë, rrugë, mënyrë dhe mjet i njohjes dhe ndërtimit të interaksionit ndërmjet edukatores dhe

fëmijëve (Sadiku, 2018). Metodën mësimore janë procese të veprimeve të përbashkëta të edukatores dhe fëmijëve në mësim. Ato janë struktura të përmbajtjes didaktike (ang. didactic content structures), të organizuara dhe të planifikuara drejtë organizimit dhe zhvillimit të procesit edukativ në përvetësimin e diturive (ang. knowledge), shkathtësive (ang. skills) dhe shprehive (ang. habits) të reja, si dhe të përsëritjes dhe përforsimit të tyre. Duke pasur parasysh këtë, edukatorët në veprimtarinë e tyre duhet të aplikojnë një sërë metodash, strategjish dhe teknikash mësimore (ang. teaching methods, strategies and techniques), ku fëmijët ndërveprojnë në mënyra të ndryshme organizimi. Përdorimi i metodave sa më të larmishme nga edukatorët duke i përshtatur ato sipas nevojave dhe karakteristikave të fëmijëve ndihmon shumë në realizimin e qëllimeve dhe detyrave edukative dhe arsimore. Përdorimi i drejtë i tyre ndikon në formimin e personalitetit të fëmijëve, duke i aftësuar dhe përgatitur ata për jetë dhe punë, sidomos për vetësimim dhe vetëmësim (Zylfiu, 2004)

Sipas Gjokutaj (2009) fjala metodë nuk e ka kuptimin e njëjtë me fjalën strategji dhe teknikë. Sipas tij, një metodë brenda saj përfshinë shumë teknika dhe strategji (ang. techniques and strategies), të cilat realizojnë synimet e metodës në fjalë dhe përmes së cilave ne mund të arrijmë qëllimet tona (Gjokutaj, 2009). Ndërsa Kumaravadivelos (2006) e sheh metodën (ang. method) të lidhur me metodologjinë, dhe ai pohon se metoda i referohet metodës së konceptualizuar dhe të ndërtuar nga ekspertët në fushë, ndërsa metodologjia (ang. methodology) i referohet praktikave që bëjnë fëmijët në klasë për të arritur objektivat e tyre të përcaktuara apo të papërcaktuara (Kumaravadivelu, 2006)

Historikisht, metodat e mësimdhënies kanë ndryshuar shumë në përputhje me zhvillimet shoqërore, ekonomike dhe politike. Ato janë përsosur dhe modernizuar, mirëpo ka spekulime të ndryshme rreth përdorimit të tyre. Disa njerëz mendojnë se përdorimi i drejtë i tyre është kritik në procesin e të mësuarit dhe në zhvillimin e fëmijëve, kurse disa të tjerë mendojnë se përdorimi i metodës së gabuar nga ana e edukatoreve mund t'i dërgojë fëmijët drejtë largimit të interesit ndaj shkollës. Megjithatë, edhe shumë të tjerë mendojnë që njerëzit e ndryshëm mësojnë në mënyratë ndryshme dhe metodat që përdor edukatorja në mësimdhënie nuk kanë aq rëndësi sa përmbajtja që mësojnë fëmijët.

Sfida më e madhe për çdo edukatore është tërheqja e vëmendjes (ang. attracting attention) së secilit fëmijë, dhe përcjellja e ideve sa më efektive në mënyrë që të krijohet një përshtypje e qëndrueshme tek ata. Si edukatore, për ta trajtuar këtë sfidë në mënyrë efektive, duhet zbatuar ide inovative që e bëjnë përvojën e klasës shumë më të pëlqyeshme për fëmijët. Kur ato japin njohuri, mund të përdorin një sërë metodash, me qëllim që të gjithë fëmijët të angazhohen në mënyrë aktive në mësimin e materialit. Prandaj, edukatore në mësimdhënie e tyre duhet të jenë sa më fleksibile, t'i përshtatin metodat mësimore sipas nevojave të fëmijëve apo dëshirës së tyre (according to the needs of the children or their desires), në mënyrë që të bëjnë mësimin sa më interesant. Në qoftë se edukatore përdorin gjithnjë të njëjtat metoda mësimore i gjithë procesi mësimor do të kalonte në monotoni për fëmijët (monotonous teaching/learning, demotivating) dhe ata nuk do të shfaqnin më interes për njohuritë e reja. Përdorimi i drejtë i metodave dhe në mënyrë të përshtatshme ndikon pozitivisht në mësimdhënie dhe mësimnxënie efektive tek fëmijët (Cheetham et al., 2005).

1.1.2. Roli i mësimdhënies në edukimin parashkollor (The Role of Teaching in Preschool Education)

Në ditët e sotme, njohuria (ang.knowledge) dhe informacioni (ang.information) paraqesin një kontribut shumë të rëndësishëm dhe kritik për rritjen dhe mbijetesën dhe arsimi nuk shikohet thjeshtë si një mjet për të arritur ngritje shoqërore. Shoqëria duhet ta shoh atë gjithashtu si një motor përparimi në një epokë informacioni të nxitur nga rrotat e tij të njohurive dhe kërkimeve që çojnë në zhvillim. Ai jo vetëm që jep njohuri, aftësi dhe vlera të ngulitura, por është gjithashtu përgjegjës për ndërtimin e kapitalit njerëzor i cili ushqen, drejton dhe vendosë risi teknologjike dhe rritje ekonomike. Arsimi duhet të bëhet një argëtim dhe emocion për fëmijët në vend se të bëhet barrë dhe mërzitje (Senthilkumar et al., 2017).

Siç e dimë, në shoqërinë tonë njëri ndër profesionet me mjaftë përgjegjësi është ai i mësimdhënies, i cili luan një rol tejet të rëndësishëm në veprimtarinë shoqërore të fëmijëve parashkollor. Mësimdhënia (teaching) është një proces i cili planifikohet, drejtohet, organizohet nga edukatore sipas stileve të të nxënies dhe me pjesëmarrjen

aktive të fëmijëve, ku përvetësohen njohuri, përdoren metoda (ang. methods), teknika ndërvepruese, zhvillohen aftësitë, shkathtësitë, shprehitë si dhe ndodhë formimi tërësor i personalitetit të fëmijëve. “Mësimdhënia e mirë ka brenda elemente të punës së artistit dhe të studiuesit” (Musai, 1999:21).

Sipas disa studimeve thuhet se mësimdhënia nuk është faktor kryesor që përcakton se kush do të mësonte më shumë në shkollë, janë gjendja ekonomike dhe ajo shoqërore të cilat pretendohet që kanë një ndikim më të madh në këtë aspekt. Mirëpo studimet që janë bërë në kuadër të mësimdhënies hedhin poshtë këto pretendime dhe nuk pranuan që edukatorët mund të jenë të pafuqishëm përballë gjendjes ekonomike dhe asaj shoqërore të fëmijëve. Këto studime janë bërë në kopsht në kuadër të marrëdhënieve edukatore-fëmijë (ang. educator-child relationships) dhe tregojnë për forcën e mësimdhënies në jetën e fëmijëve, ku studiuesit kanë arritur në përfundim se cilësia e kësaj marrëdhënieje tregonte rezultate të mira në aspektin akademik dhe atë të sjelljes së fëmijëve gjerë në përfundim të klasës së tretë (Woolfolk, 2011).

Duke u bazuar në këtë, shohim se mësimdhënia ka një rol të rëndësishëm në jetën dhe zhvillimin e fëmijëve. Ajo kërkon edukatorë të aftë për të përmbushur zhvillimin e përgjithshëm dhe të nxënit e fëmijëve, të përkushtuar ndaj interesave e nevojave të tyre, edukatorë këta të cilët përzgjedhin lojëra, veprimtari, mjete dhe burime (ang. games, activities, tools and resources) të përshtatshme për ta bërë procesin e të nxënit sa më efektiv.

1.2. Metoda tradicionale e mësimdhënies (Traditional teaching method)

Shpeshherë metodat e mësimdhënies të përdorura në orët tona mësimore janë të kufizuara. Shumë orë mësimi janë të mërzitshme. Ato zhvillohen në mënyrë standarde dhe nuk i përgjigjen situatave konkrete në të cilat zhvillohet mësimi.

Metoda tradicionale (ang.traditional teaching) është ai model i mësimdhënies e cila zhvillohet në atë mënyrë, ku edukatorja kontrollon tërë procesin mësimor dhe e shpjegon tërë përmbajtjen mësimore me anë të ligjërimit, ndërsa fëmijët vetëm e dëgjojnë atë. Kështu mënyra e të mësuarit ka tendencë të jetë pasive dhe fëmijët marin

shumë pak pjesë në procesin e të mësuarit. Në mësimdhënien tradicionale në të cilin edukatorja flet pa ndërprerë (ang. Teacher Taking Time -TTT), fëmijët nuk kanë interesim për atë që thuhet dhe nuk marrin vesh asgjë që ajo shpjegon, gjë që është e merzitshme nga ana e fëmijëve. Edukatorja në këtë rast është dërguesi ose burimi i informacionit, të cilin e bënë përmes metodës shkumës dhe të folur. Ajo është në qendër të procesit mësimor (ang. teacher centered method), si dhe e ka në kontroll tërë procesin e mësimdhënies (Cheetham et al., 2005). Duke u bazuar në këtë, shohim se kjo metodë nuk është efektive për të arritur të gjithë fëmijët, pasi që ata shpesh kanë nevojë për një strategji më praktike dhe më tërheqëse, në mënyrë që të mësojnë në mënyrë efektive. Qëllimet dhe detyrat edukative dhe arsimore në mësimdhënie realizohen përmes metodave sa më efikase nga ana e edukatoreve, përkatësisht organizohen ecuritë didaktike të punës mësimore. Andaj përdorimi i këtyre metodave në mënyrë sa më të përshtatshme nxit tek fëmijët kreativitet, interesim dhe kureshtje (child's creativity, interest and curiosity)

Nxjerrë nga shumë observime nga shumë edukatore dhe fëmijë, është gjetur se kjo formë e mësimdhënies brenda në klasë ka një efikasitet të kufizuar si në mësimdhënie poashtu edhe në mësimnxënie. Nga një metodë e tillë, fëmijët thonë se luajnë një rol pasiv (ang. passive role) dhe koncentrimi i tyre zbehet pas 15-20 minutash.

Sipas Musait (2003) metoda tradicionale (ang. Traditional method) paraqet një sjellje të niveleve të ulëta dhe të thjeshta të fushave njohëse, emocionale. Kjo metodë kërkon kombinimin e fakteve dhe të rregullave në nivelin e njohurive dhe të kuptuarit nëpërmjet disa veprimeve zbatuese që mund të përvetësohen përmes vëzhgimit, përsëritjes përmendësh dhe ushtrimit (Musai, 2003). Pra, në këtë mësimdhënie sigurohet një shkallë e lartë e kontrollit nga ana e edukatores, e cila është e përqendruar në përmbajtjen e lëndës, sepse siguron mësimdhënie, ritëm në të nxënë, korrigjim dhe vlerësim të përgjigjeve të fëmijëve.

Shembuj të metodave tradicionale të mësimdhënies janë ligjërimi (ang. lectures), diktimi (ang. dictation), ushtrimet (ang. exercises), diskutimet e udhëhequra nga edukatorët (ang. discussions led by the teacher) dhe shpjegimet, (ang. explanations) etj.

1.2.1. Përparësitë dhe dobësitë e metodës tradicionale (The advantages and disadvantages of the traditional method)

Metoda tradicionale (ang.traditional methods) është një metodë që i ka themelet e saj në perspektivën e të mësuarit të sjelljes dhe është një teknikë popullore, e cila është përdorur nga edukatorët për dekada të tëra si një strategji edukative në të gjitha institucionet e të mësuarit. Mësimdhënia tradicionale në të cilën flet vetëm edukatorja nuk mund të plotësohen të gjitha nevojat e fëmijëve, pasi që procesi mësimor ka rrjedhë një drejtimshe të informacionit (ang. one-way flow of information).

Metoda tradicionale e mësimdhënies sipas Bonk (et al., 2014), përfshinë disa dobësi (ang. includes some downsides):

- Kurrikula është jofleksibile (ang.not flexible) ashtu siç është edhe roli i edukatores
- Kur thuhet uniformë nënkuptohet që sistemet janë të ngadalshme në ndryshim dhe më pak në gjendje të jenë në nivel me nevojat e fëmijëve
- Mësimdhënia fokusohet në të mësuarit përmendësh dhe jo në aftësitë e të menduarit në nivel më të lartë, ku ngecin edhe më shumë fëmijët të cilët kanë ngecje në mësimin përmendësh
- Nevojat e fëmijëve me paaftësi të ndryshme rrallëherë plotësohen si duhet
- Bazohet në mendimin e gabuar se të gjithë fëmijët janë në një nivel loje dhe disa nga ta “thjeshtë” dështojnë (Bonk et al., 2014)

Poashtu, Bonk (et al., 2014), pohojnë se përkundër të gjitha këtyre dobësive të lartpërmendura, metoda tradicionale e mësimdhënies nuk është se nuk ka edhe ndonjë përparësi dhe përparësitë e saj përfshijnë (ang. includes some advantages):

- Mësimdhënia është uniformë dhe konsistente
- Temat dhe aftësitë bëhen në radhitje specifike, kohezive
- Vlerësimi i edukatoreve është më i drejtpërdrejt
- Vlerësimi i shkollave nga drejtori i shkollave dhe departamenteve të saj bëhet më lehtë (Bonk et a.l., 2014).

1.3. Metoda bashkëkohore e mësimdhënies (Contemporary teaching method)

Nga vet emërtimi, mësimdhënia bashkëkohore (ang.contemporary teaching) nënkupton një mësimdhënie ndryshe nga ajo tradicionale. Këtë mund ta nënkuptojmë në shumë aspekte si: në metoda, strategji, teknika, forma, në të kuptuarit dhe të menduarit ndryshe, në ndryshimin e rolit të edukatoreve dhe fëmijëve, në respektimin e të drejtave të fëmijëve, në përcaktimin e objektivave, në vlerësim etj.

Me mësimdhënie bashkëkohore duhet të kuptojmë atë lloj mësimdhënie, e cila lehtëson procesin mësimor në forma, metoda, teknika, dhe strategji të përshtatshme. (ang. forms, methods, techniques, and strategies). Në të kundërtën e mësimdhënies tradicionale e cila ka tendencë të të nxënit pasiv, mësimdhënia bashkëkohore nënkupton të nxënit aktiv, ku si fokus kryesor e ka fëmijën në qendër, të menduarit në mënyrë kritike dhe krijuese. “Mësimdhënia është një detyrë e vështirë dhe komplekse dhe kërkon njohuri, aftësi e shprehje të shumta” (Musai, 2003:11).

Përvoja vetanake e fëmijëve, nevojat, interesat dhe aftësitë janë thelbësore gjatë mësimdhënies dhe të të nxënit. Prandaj, në mësimdhënien bashkëkohore fëmijët nxiten në procesin mësimor si dhe në veprimtari të ndryshme për përvetësimin e diturive të reja, gjithëherë duke u mbështetur në përvojën, interesat, nevojat, shkathtësitë dhe aftësitë e tyre (ang. their experience, interests, needs, skills and abilities). Kjo metodë e mësimdhënies e cila tejkalon të nxënit riprodhues, krijon kushte për një mësimdhënie më cilësore. Fëmijët janë në gjendje të bëjnë rindërtimin e koncepteve, ideve dhe mendimeve përmes procesit të njohjes, veprimit dhe ndërveprimit. “Mësimdhënia bashkëkohore nënkupton ndryshimin e roleve të mësuesit dhe nxënësit, me qëllimin kryesor - lehtësimi i të nxënit” (Rama, 2011:27).

Sipas Rama (2011) mësimdhënia bashkëkohore mbështetet në disa parime:

- Aftëson nxënësit për të nxënit e pavarur
- Nxit nxënësit që të jenë nismëtar
- Krijohet dallueshmëri në të nxënë dhe nxitet të menduarit kritik, krijues
- Nxit dhe krijon kushte për komunikim shumëkahor dhe të frytshëm
- Aftëson nxënësit për vlerësim dhe vetëvlerësim (Rama, 2001).

Mësimdhënia bashkëkohore i aftëson fëmijët, i nxit ata në veprimtarit mësimore, t'i gjejnë vet burimet e informacionit, të zhvillojnë aftësitë, shkathtësitë dhe formojnë shprehitë e tyre. Për arritjen e këtyre rezultateve duhet krijuar kushte, një mjedis të përshtatshëm mësimor. “Prandaj detyrë e mësuesit është të krijoj një mjedis sa më të përshtatshëm dhe mjedis të ngrohtë pune, ku secili fëmijë të ndjehet i lirshëm të shprehë mendimin e vet, të besoj në vetvete, të besojnë te mësuesi dhe shokët e tij” (Rama, 2011:30).

Në mësimdhënien bashkëkohore procesi mësimor realizohet duke u mbështetur në metodat dhe teknikat bashkëkohore, përmes së cilave fëmijët mësojnë për të vlerësuar, reflektuar, zbuluar dhe për të zgjidhur probleme të ndryshme. Prosesi mësimor është një veprimtari që ndryshon vazhdimisht, në të cilin fëmijët kryesisht janë dëgjues dhe pjesmarrës aktiv.

Sipas Musait (1999) metodat bashkëkohore paraqesin sjellje të niveleve më të larta (ang. represent higher-level behavior), më të ndërlikuara të objektivave në nivelet e analizës, sintezës dhe vlerësimit të fushës njohëse, nivelet e organizimit dhe karakterizimit të fushës emocionale, nivelet e artikulimit dhe natyralizimit të fushës psikomotore (Musai, 1999). Në mësimdhënien bashkëkohore planifikohen metoda, teknika, forma të përshtatshme në procesin mësimor, ku edhe ndryshon pozita e fëmijëve dhe edukatoreve, ndërsa shkolla është më e hapur ndaj mjedisit shoqërorë. Prandaj për të arritur rezultate dhe suksese duhet që në planifikimin e punës mësimore të përfshihen më shumë strategji gjithpërfshirëse dhe me fëmijën në qendër, për të përmbushur një mësimdhënie dhe të nxënë cilësor.

1.3.1. Metodologjia “Fëmija në qendër” (Child-centered methodology)

Metodologjia “fëmija në qendër” (ang. methodology “child in the center”), është pjesë përbërëse e mësimdhënies bashkëkohore, e cila ndryshe nga mësimdhënia tradicionale në të cilën edukatorja ishte në qendër të procesit mësimor, këtu është fëmija me karakteristikat e tij vetanake.

Duke u larguar nga kopshti tradicional, në mësimdhënien “fëmija në qendër”, edukatorët tregojnë një qasje më të përqendruar tek fëmijët, e cila i inkurajon ata të

marrin mësimin në duart e tyre. Kjo e bënë më të konsiderueshëm procesin mësimor në krahasim me drejtimin dhe nxitjen e tij vetëm nga ana e edukatores. Fëmijët marrin përgjegjësi për të bërë zgjedhje për ato që do të mësojnë dhe hulumtojnë. Edukatorët vetëm dëgjojnë sugjerimet dhe interesat e tyre dhe janë ndihmëse dhe lehtësuese (ang. auxiliary and facilitating) në procesin e të nxënës.

Metodologjia me në qendër fëmijën është metodë e cila është më e pranishme tani dhe siguron më shumë mësimdhënie të hapur, më pak të nxënës të drejtuar nga edukatorët dhe më shumë të nxënës bashkëveprues. Sipas Qendrës së Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin – QTKA (2005), mësimdhënia me në qendër fëmijën (student-centered teaching) ka për qëllim që të shfrytëzojë kontributin e qdo fëmije që ndodhet i pranishëm në mjedisin e të nxënës, në mënyrë që diturinë ta ndërtojnë vetë dhe jo ta marrin të gatshme. Në mësimdhënien fëmija në qendër, fëmijëve ju ofrohen mundësi të mira në përvetsimin e njohurive, zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive, të bashkëpunojnë dhe integrohen etj. “Mësimdhënia me në qendër nxënës inicion një lëvizje progresive për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Nisma synon që të shtrihet dhe të kthehet në një lëvizje të gjerë arsimore, në të cilën të përfshihen specialistët e të gjitha niveleve të arsimit shqiptar” (QTKA, 2005).

1.4. CKA ËSHTË INOVACIONI (WHAT IS INNOVATION)?

Inovacioni (ang.innovation) në kuptimin e tij modern është një ide e re, një risi, metodë dhe mendim krijues i cili në arsim zbatohet në formë të metodave të mësimdhënies. Inovacioni shpesh shihet edhe si aplikim i zgjidhjeve më të mira që plotësojnë kërkesa të reja, nevoja të paartikuluara, ose nevoja ekzistuese të tregut. Një inovacion i tillë bëhet përmes sigurimit të produkteve, proceseve, shërbimeve, teknologjive, apo modeleve më të efektshme të biznesit, të cilat vihen në dispozicion të tregjeve, qeverive dhe shoqërisë. Për të bërë diçka ndryshe kërkohet të vihet një qasje, proces, produkt, metodë apo strategji e re (ang. a new approach, process, product, method or strategy).

1.4.1 Roli dhe rëndësia e inovacionit në arsim (The Role and Importance of Innovation in Education)

Inovacioni në arsim (ang. innovation in education) ka një rëndësi të padiskutueshme, pasi që ai është proces i bërjes së jetës sonë më të mirë, dhe na shtyen të përpiqemi për një të ardhme më të mirë. Inovacioni në arsim inkurajon edukatorët dhe fëmijët të hulumtojnë dhe përdorin të gjitha mjetet dhe metodat për të zbuluar diçka të re. Ai përfshinë një mënyrë tjetër për të parë problemet dhe zgjidhjen e tyre. Procesi i të menduarit që hyn në të do të ndihmojë fëmijët të zhvillojnë krijimtarinë (ang. creativity) dhe aftësitë (ang. skills) e tyre për zgjidhjen e problemeve.

Inovacioni në arsim është më shumë se një qasje e re i cili përmirëson arsimin dhe i detyron fëmijët të përdorin një nivel më të lartë të të menduarit për të zgjidhur problemet. Aktivitete që ndodhin në një klasë mësimi të bazuara në projekte inovuese dhe lojëra qysh në fëmijërinë e hershme, mbështesin hetimin dhe kreativitetin e fëmijëve dhe kanë përfitime të konsiderueshme afatgjata, përmes së cilave fëmijët eksplorojnë konceptet të ndryshme. Prandaj duhet të përqëndrohemi në dispozitat krijuese të të mësuarit herët, sepse kjo është periudha më aktive të rritjes sinaptike të trurit të fëmijëve (Garcia, 2014).

Inovacioni ose risia në arsim nuk përfaqësohet vetëm duke prezantuar ose zbatuar ide ose metoda të reja. Inovacionit mund të përcaktohet edhe si një proces që përfshinë veprimtari të shumta për të zbuluar mënyra të reja për të bërë gjëra. Meqenëse punëtorët më të vlefshëm për firmat janë ata që janë në gjendje të inovojnë dhe të përshkatan me teknologjitë e reja dhe risitë e tjera, kjo është mënyra më e drejtpërdrejt për të hetuar nevojën për inovacion në arsim. Nëse aftësitë matematikore shpërblehen shumë në tregun e punës, ndryshimet që përmirësojnë aftësi të tilla janë risi të rëndësishme në arsim. Në vend që të mësojmë thjeshtë ABC dhe 123, inovacioni mund të shkojë përtej bazave duke kombinuar një larmi disiplinash për të dalë me një përfundim të ri ose të ndryshëm.

Sipas Social Entrepreneurship Empowering Development in Preschools – SEEDS (2019), një shembull ku shihet rëndësia e inovacionit në edukimin parashkollor, si faktor i rëndësishëm për zhvillimin e shoqërisë së shekullit 21, është takimi i edukatoreve European në Shkurt 2109, në Universitetin e Aarhus. Qëllimi i tyre ishte

të mendojnë për metoda inovative që do të promovonin “4 C-të” e njohura në edukim si: **critical thinking** (mendimi kritik), **collaboration** (bashkëpunimi), **creativity** (kreativiteti) dhe **communication** (komunikimi). Në këtë takim edukatorët përjetuan drejtpërdrejt përdorimin e produkteve të robotëve, si mjete inovative për të stimuluar krijimtarinë dhe mendimin kritik të fëmijës. Duke përdorur pajisje të tilla, fëmija mund të simulojë situata reale, të krijojë histori dhe karaktere, të personalizojë robotët dhe t'i bëjë ata të lëvizin për të shprehur ndjenjat. Roboti më pas vepron si një mjet për zbulimin dhe mësimin, si dhe për zhvillimin e krijimtarisë dhe shprehjen e emocioneve të fëmijëve (SEEDS, 2019).

1.4.2. Metodatat inovative të mësimdhënies në edukimin parashkollor (Innovative teaching method in preschool education)

Aktualisht, qasja e metodës tradicionale arsimore ka rezultuar në një mospërputhje midis asaj që u mësohet fëmijëve dhe asaj që i duhet industrisë. Për shkak të kësaj tani shumë institucione po shkojnë drejtë mësimin të bazuar në probleme (ang. PBL-problem-based learning), si një zgjidhje për zbulimin e fëmijëve e që janë krijuar dhe mund të mendojnë në mënyrë kritike, analitike dhe në zgjidhjen e problemeve (ang. critical, analytical and problem solving). PBL, ndër të tjera, promovohet si një metodologji inovative e mësimdhënies dhe mësimin që është shumë e rëndësishme dhe domethënëse dhe ia vlen të përdoret (Garcia, 2014; Senthilkumar et al., 2017).

Mësimi i bazuar në probleme është duke u bërë gjithnjë e më i popullarizuar në institucionet arsimore si një mjet për të adresuar pamjaftueshmërinë e mësimdhënies tradicionale. Meqenëse këto qasje tradicionale nuk i nxisin fëmijët të pyesin atë që kanë mësuar ose të lidhen me njohuritë e fituara më parë, mësimi i bazuar në probleme shihet si një masë inovative për të inkurajuar fëmijët (ang. encourage children) si të mësojnë përmes problemeve në jetën reale (Brigham, 2001). Kjo metodë e re e mësimdhënies bazuar në përvojën “të mësuarit duke bërë” dhe në shprehjen e lirë të fëmijës zëvendëson metodën tradicionale të mësimdhënies, në të cilën mësuesi jep udhëzime dhe rregulla. Prandaj, në ndryshim të kësaj mund të themi se praktikatat inovative të mësimdhënies janë mënyra e vetme për të përmirësuar cilësinë e arsimit tonë.

Sipas Kalyani (et al., 2018) mësimdhënia inovative nënkupton krijimtarinë dhe risinë e edukatoreve e cila ndryshon stilin dhe metodën e mësimdhënies. Mësimdhënia inovative është e nevojshme për të tashmen dhe të ardhmen e arsimit për të ndihmuar fëmijët të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Ajo është një domosdoshmëri për të gjithë edukatorët në mënyrë që të plotësojnë nevojat arsimore të brezave të rinj (Kalyani et al., 2018).

1.4.3. Përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies (Using innovative teaching methods)

Në të gjithë botën, institucionet parashkollore (ang. preschool institutions) po zbatojnë ide të reja, metoda dhe risi të bazuara në teknologji për të rritur njohuritë e fëmijëve. Ato po luftojnë për të mësuar dhe për të punuar shumë në krijimin e një mjedisi të ri mësimi. Qëllimi i edukimit nuk është vetëm mësimi i librit të tekstit që i bën fëmijët të kuptojnë, por gjithashtu shton të menduarit novator në një mjedis krijues. Kjo është arsyeja pse institucionet duhet të përfshijnë metoda inovative të komunikimit që japin njohuri të mira.

Hulumtimet kanë treguar se metoda dhe qasja e duhur mund të rrisin vërtetë aftësinë e të mësuarit. Disa metoda inovative të mësimdhënies mund të jenë kombinimi i llojeve të ndryshme të mediave dixhitale, si teksti (ang.text), imazhet (ang.images), audio dhe video, në një aplikim ose prezantim interaktiv shumë sensorë të integruar, në mënyrë që informacioni të përcjellet në mënyrën më të mirë tek fëmijët. Kombinimi i metodave të ndryshme krijon mundësi më të mira që fëmijët të jenë më të angazhuar në procesin mësimor. Kur fëmijët janë të angazhuar me mësimin që u mësohet, ata mësojnë më shumë dhe mbajnë në mend më shumë. (Kalyani et al., 2018).

Zbatimi i metodave inovative të mësimdhënies është thelbësorë nëse do të motivojmë dhe krijojmë një frymë të të mësuarit, si dhe entuziazëm nga ana e fëmijëve për të mësuar gjatë gjithë jetës. Kështu, edukatorët duhet të zbatojnë metoda novatore, në mënyrë që procesi mësimor i fëmijëve të jetë sa më i rrjedhshëm dhe se metodologjia që ata adoptojnë të jetë e favorshme për të nxënë (Senthilkumar et al., 2017). Duke pasur parasysh këtë, shohim se përdorimi i metodave inovative është i nevojshëm në shumë aspekte në arsim, pasi që përmirëson arsimin dhe detyron fëmijët të përdorin një nivel më të lartë të të menduarit (ang. higher level of thinking). Ato i mundësojnë

fëmijëve të përdorin njohuri dhe koncepte për të gjetur zgjidhje duke eksploruar derisa të gjejnë përgjigjet më të mira. Prandaj, edukatorët duhet të bëhen novatore dhe krijuese të ndryshimit në pedagogji, duke përdorur teknologji dhe mjete dixhitale, si dhe të jenë krijuese në mënyrë që të arrijnë qëllimet e të mësuarit.

Duke u nisur nga ajo se çka u tha më lartë për edukimin parashkollor, mësimdhënien, metodat tradicionale, bashkëkohore dhe inovative, ky punim parashtron këto pyetje:

- 1.Cilat janë metodat inovative në edukimin parashkollor në kuptimin global?
- 2.Si ndikojnë metodat inovative në edukimin parashkollor?
- 3.A janë të aplikueshme metodat e tilla në vendin tonë?

2.METODOLOGJIA

Ky punim është një punim deskriptiv (descriptive paper), me anë të së cilit janë mbledhur të dhëna përshkruese që kanë të bëjnë me metodat tradicionale, bashkëkohore dhe inovative në edukimin parashkollor. Qëllimi i këtij punimi është që të përshkruaj dhe të vlerësojë rëndësinë e metodave të mësimdhënies tradicionale dhe bashkëkohore midis së cilave bëhen edhe krahasime, si dhe nëpërmjet shqyrtimit të literaturës së gjuhës angleze të ofrojë shembuj të ndryshëm të metodave inovative të cilat do të ndikojnë pozitivisht edhe në vendin tonë.

Si instrument bazë për mbledhjen e këtyre të dhënave kanë shërbyer punimet e autorëve të ndryshëm bashkëkohorë në fushën e edukimit parashkollor, të tillë si:

- Bell, N., Zenin, G. & Williams, J.(2017). Tackling Bullying in Early Childhood: STEM in the early years. *Early Horizons*. The Danish Forest School Approach - ASG
- Damotharan V.S. & Rengarajan, V. (2006). Innovative Methods of Teaching,
- Garcia, E. (2014). Innovative Practice: 5 Strategies for the Early Learning Classroom
- Saeideh, A., Mohammad, Y. & Keshtiaray, N. (2015). Methods of Nurturing Creativity during Preschool Term: An Integrative Study,
- Senthilkumar. V., & Kannappa. R. (2017). Impact of Innovative Teaching and Learning Methodologies for Higher Educational Institutions with Reference to Trichirappalli District
- Kalyani. D. & Rajasekaran. K. (2018). Innovative Teaching and Learning. *Journal of Applied and Advanced Research*,
- Choi, B., Jangho, P., Kim, H.R. & Kim, H.W. (2014). The Effects of a Forest Kindergarten Program on the Sleep Habits of Preschool Children të cilat si objekt studimi kanë pasur aplikimin e metodave inovative në insitucione parashkollore.

Analiza dhe sinteza e këtyre punimeve diskutohet në kapitullin e rradhës, mbi metodat inovative të mësimdhënies në edukimin parashkollor në kuptimin global, ndikimin e këtyre metodave si dhe aplikimin e tyre tek fëmijët parashkollor në Kosovë.

3.DISKUTIME

Duke u bazuar në pyetjet e shtruar të këtij punimi, të cilat janë edhe fokus kryesor i këtij studimi, është arritur që nëpërmjet shqyrtimit të literaturës së gjuhës angleze të analizohen dhe ofrohen të dhënat e duhura në lidhje me to. Sa i përket pyetjes së parë se “Cilat janë metodat inovative në edukimin parashkollor në kuptimin global?”, shohim se ekzistojnë në shumëllojshmëri e metodave inovative të mësimdhënies, ndër të cilat janë: teknologjia multimediale (ang.multimedia technology), e cila është një pjesë e pandashme e botës ku jetojmë, mirëpo në edukimin parashkollor nuk është që aplikohet në masë të madhe, pastaj kemi edhe mësimdhënien krijuese (ang.creativity teaching), luajtjen e roleve (ang.rol play), klasat jashtat klasës (ang.classes outside the classroom) dhe kopshtet pyjore (ang.forest kindergarden), metoda këto të cilat nxitin interesim dhe kureshtje tek fëmijët në mësim si dhe kanë një rëndësi të veçantë në procesin edukativo-arsimor.

3.1. Teknologjia Multimediale (Multimedia Technology)

Ka shumë teknologji multimediale që janë në dispozicion për të zhvilluar dhe për të krijuar ide inovative, siç janë teksti, fotografitë, audiot dhe videot me anë të se cilave edukatorët mund ta përçojnë materialin mësimor apo informacionin tek fëmijët. Edukatorja mund të përdor multimedia për të modifikuar përmbajtjen e materialit. Kjo e ndihmon atë të përfaqësojë (prezantojë) njohuritë në një mënyrë më kuptimplotë, duke përdorur elemente të ndryshme të mediave. Këto elemente të mediave mund të shndërrohen në formë dixhitale (ang. digital form), të modifikohen dhe të personalizohen për prezantimin përfundimtar (Kalyani et al., 2018). Duke përfshirë elementët e mediave dixhitale në projekt, fëmijët janë në gjendje të mësojnë më mirë pasi përdorin modalitete të shumta shqisore (ang. multiple sensory modalities), gjë që do t'i bënte ata më të motivuar t'i kushtojnë më shumë vëmendje informacionit të paraqitur dhe të ruajnë më mirë informacionin.

Krijimi i projekteve multimedia është sfidues dhe emocionues. Për fat të mirë, ekzistojnë shumë teknologji multimediale që janë në dispozicion për të krijuar këto aplikacione inovative dhe multimedia interaktive. Këto teknologji përfshijnë Adobe Photoshop dhe Premier për të krijuar përkatësisht modele grafike dhe video skedarë, SoundForge dhe 3D Studio Max për të krijuar dhe / ose modifikuar tingullin etj. Një tjetër avantazh i krijimit të projekteve multimedia në mjedisin e klasës është se fëmijët prirën më shumë ta bëjnë këtë në një mjedis grupor. Duke punuar në një grup, fëmijët duhet të mësojnë të punojnë në mënyrë bashkëpunuese dhe bashkëvepruese, duke përdorur aftësitë e tyre në grup dhe një sërë aktivitete për ti realizuar objektivat e përgjithshëm të projektit (Damodharan et al., 2006; Kalyani et al., 2018).

Teknologjitë dhe inovacionet e reja në sistemin arsimor shpesh mendohen si shtytës për rezultate më të mira arsimore. Për shembull, përfshirja e materialit mësimor në mënyrë audio-vizuale (ang. audio-visual) tek fëmijët mund të zhvillojë aftësitë e tyre për të dëgjuar, si dhe i ndihmon ata t'i kuptojnë më mirë konceptet. Ato mund të jenë modele, filma, fotografi të ndryshme të asaj që edukatorja shpjegon.

Ekzistojnë gjithashtu një numër aplikacionesh inteligjente për edukatore parashkollore që mund të përdoren për të krijuar pamje të mrekullueshme ose prezantime. Mjete të tilla ndihmojnë shumë në imagjinatën e fëmijëve. Mjetet e reja të teknologjisë ndryshojnë përvojën në klasë (Kalyani et al., 2018).



Figura 1. Zhvillimi i procesit mësimor me anë të mjeteve teknologjike.

3.1.1 Mësimdhënia krijuese (Creativity teaching)

Duke e ditur se shumica e institucioneve parashkollore në vendin tonë aktualisht po përjetojnë një "boshllëk krijimtarie" me aktivitete domethënëse dhe kreative, psikologë të shumtë argumentojnë se krijimtaria ka një rëndësi të veçantë në zhvillimin e fëmijëve dhe duhet të jetë pjesë e çdo insitucioni parashkollor. Ajo është një grup aftësish i përcaktueshëm, i matshëm, psikologjik, që përmirëson të mësuarit.

Kërkimet tregojnë se periudha parashkollore është epoka e artë e krijimtarisë, në të cilën krijimtaria fillon që në fëmijërinë e hershme dhe bëhet e qëndrueshme gjatë adoleshencës. Në rastin e nxitjes së krijimtarisë (ang. fostering creativity) në këtë periudhë të jetës, njeriu mund ta zgjasë atë deri në fund të jetës. Për shembull, Oncu dhe Unluerin në hulumtimin e tyre të titulluar “Përdorimi krijues i fëmijëve nga materialet e luajtjes”, ata e konsiderojnë lojën si një nga aktivitetet më të rëndësishme që promovojnë krijimtarinë dhe imagjinatën e fëmijëve.

Edhe sipas Saeideh (et al., 2015), një rëndësi të veçantë ka promovimi i kreativitetit të fëmijëve parashkollor, ku rezultatet tregojnë se promovimi i të menduarit krijues është raportuar në moshën parashkollore. Programet e trajnimit të krijimtarisë mund të ndihmojnë fëmijët të kuptojnë botën përreth tyre dhe të ndërtojnë marrëdhënie midis përbërësve të tij dhe të rrisin fleksibilitetin, imagjinatën (ang.flexibility, imagination) dhe aftësitë e fëmijëve (Saeideh et al., 2015)

Në mësimdhënien krijuese edukatorja me ndihmën e mjeteve krijuese stimulon kreativitetin tek fëmijët. Përfshirë lojërat lozonjare ose format e ushtrimeve vizuale përmes së cilave zgjonë mendjet e fëmijëve dhe tërheqë interesin e tyre. Një edukatore kreative mund të indentifikojë aftësitë krijuese të secilit fëmijë, duke sjellë aspekte të ndryshme të krijimatarisë në të gjitha fushat e zhvillimit, në të cilat fëmijët mund të eksplorojnë dhe të shfaqin idetë e tyre krijuese. Kreativiteti gjithashtu rritë drejtpërdrejt mësimin duke rritur motivimin (ang.motivation), thellimin e të kuptuarit dhe promovimin e gëzimit. Motivimi i brendshëm është thelbësorë për procesin krijues dhe mbështetet te fëmijët që ndjekin qëllime kuptimplotë.

Studiuesit e krijimtarisë Scott Barry Kaufman dhe Carolyn Gregoire shkruajnë në librin e tyre *Wired to Create*: "Krijimtaria nuk ka të bëjë vetëm me inovacionin ose bërjen e artit - ka të bëjë me të jetuarit në mënyrë krijuese".

Ne mund t'i qasemi çdo situatë në jetë me një frymë krijuese. Edukatorët që mund të modelojnë mënyra krijuese të menduarit, përfshihen në mënyrë miqësore me përmbajtjen dhe shprehin idetë e tyre. Fëmijët janë ata që duhet të shohin edukatorë që kanë pasione, qoftë vizatim, matematikë, pikturë, muzikë ose teatër, sepse vetëm në këtë mënyrë edhe ata fillojnë të jenë krijues. Edukatorët të cilat janë të përmbushura në mënyrë krijuese mund të jenë gjithashtu edhe edukatorë të lumtura. Një studim në *Gazetën e Psikologjisë Pozitive* sugjeron që përfshirja në një aktivitet krijues - bërja e shkathët, luajtja e një instrumenti muzikor, thurja, dizenjimi - vetëm një herë në ditë mund t'ju çojë në një mendje më pozitive. Kjo gjendje shpirtërore pozitive do t'ju mbajë, dhe përhapet tek fëmijët tuaj (Davis, 2018).

3.1.2. Luajtja e roleve (Rol Play)

Luajtja e roleve është njëri ndër aktivitetet më të pëlqyera për fëmijët parashkollor. Mësimdhënia përmes roleve është një mënyrë e shkëlqyeshme për t'i bërë fëmijët të largohen nga zona e tyre e rehatisë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre ndërnjerëzore. Kjo metodë vjen në ndihmë, veçanërisht kur mësojmë diçka në lidhje me jetën reale (ang. real life). Qasja për të luajtur role ndihmon shumë fëmijët të kuptojnë se si materiali akademik do të jetë i rëndësishëm për detyrat e tyre të përditshme. Loja me role (ang. rol play) është efektive për fëmijët e pothuajse çdo grupmoshe. Vetëm se duhet siguruar që sqarimet janë mjaftueshëm të thjeshta për të kapur hapësirën e kufizuar të vëmendjes së fëmijëve (Kalyani et al., 2018).

Duke u bazuar në këtë, shohim se përfitimet e luajtjes së roleve midis fëmijëve janë thelbësore në rritjen e aftësive të kërkuara për zhvillim të shëndetshëm. Së bashku me të qenurit argëtues, përdorimi i imagjinatës në lojën e tyre përmirëson krijimtarinë e tyre dhe promovon performancë më të mirë në kopsht dhe gjithashtu i ndihmon ata të zhvillojnë një qasje të fortë për zgjidhjen e problemeve (ang. problem solving) në trajtimin e çështjeve. Kjo për shkak se u lejon atyre të marrin personazhe që veprojnë

jashtë roleve të jetës reale. Përmes saj promovohet një vlerësim dhe sintezë e materialit mësimor ndërsa praktikisht i lejon fëmijët të mësojnë “duke bërë” (Senthilkumar et al., 2017).

Ekzistojnë disa lloje të roleve në lojëra të cilat fëmijët pretendojnë se janë :

Mjekët, policia, mësuesit apo edhe ndërtuesit të cilat janë disa nga rolet që inkurajojnë empatinë midis fëmijëve dhe ngjallin te ta imagjinatën.



Figura 2. Fëmijët në luajtjen e rolit të mjekut dhe pacientit

3.1.3. Klasat jashtë klasës (Classes Outside the Classroom)

Për ta bërë procesin mësimor me inovues në mënyrë që aktivitetet të zhvillohen më mirë, atëherë duhet organizuar që procesi mësimor të zhvillohet jashta klase. Disa mësimet mësohen më mirë, kur mësohen jashtë klasës, dhe për këtë duhet organizuar udhëtime në terren që janë të rëndësishme për mësimet ose thjesht t'i marrim fëmijët për një shëtitje jashtë klasës (ang. a walk outside the classroom). Fëmijët do të shohin këtë orë mësimore më të freskët dhe me emocionuese. Po ashtu, pa bërë shumë përpjekje ata do të mësojnë dhe do ta mbajnë në mend me mirë atë që u mësohet (Kalyani et al., 2018).

Sipas ekspertëve kryerja e aktiviteteve të rregullta në natyrë i ndihmon fëmijët në:

1. rritjen dhe zhvillimin e krijimtarisë së fëmijës,
2. përmirëson përqendrimin e vëmendjes,
3. përmirëson kuptueshmërinë,
4. garanton një ekuilibër në zhvillimin fizik,
5. ndihmon në lidhjen shoqërore dhe në aktivitetet në grup,
6. rritë disiplinën ndaj vetes dhe rregullimin e tij
7. ulë nivelin e stresit (Sadiku, 2018).

Kërkimet tregojnë se fëmijët me qasje në jetën e përditshme në natyrë dhe zonat e gjelbërta janë më aktiv fizikisht, lëvizin më lirshëm dhe janë më pak të sëmurë. Duket se fëmijët që kalojnë kohë jashtë kanë përqendrim më të mirë dhe janë më të gatshëm për të mësuar (gjithashtu në klasë). Për më tepër, ata janë shumë më mirë në aspektin social dhe janë më kreativë dhe inovativë.

3.1.4. Kopshtet pyjore (Forest Kindergarden)

Kopshtet pyjore janë pjesë e një sistemi të veçantë shkollor që inkuadron arsimin e fëmijëve në natyrë, ku fëmijët i kalojnë ditët e tyre pothuajse ekskluzivisht jashtë. Fëmijët në këto "kopshte pyjore" mbikëqyren gjithmonë, por ata kanë lirinë të eksplorojnë, të luajnë dhe të shoqërohen (ang. explore, play and socialize). Gjatë rrugës, ata mësojnë se si të punojnë, bashkëveprojnë me mjedisin dhe njëri-tjetrin. Ata mësojnë të kenë besim në aftësitë e tyre. Ky mjedis lejon që fëmijët të zhvillojnë kreativitetin, imagjinatën, koncentrimin, vetë-disiplinën, pavarësinë, qëndrueshmërinë motorike, dhe funksionimin konjitiv të tyre. Për më tepër, fëmijët në kopshtet pyjore mësojnë se si të punojnë, të ndajnë, të bashkëpunojnë dhe të zgjidhin konfliktet me të tjerët në një mjedis natyror (Choi et al., 2014). Ky stil i të mësuarit që zhvillohet jashtë klasës tradicionale e ka origjinën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Danimarkë, Finland, Suedi dhe Gjermani.

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka ambienti i jashtëm për fëmijët, mund të cekim Danimarkën si një ndër vendet më të veçanta në të cilën ka institucione parashkollore për fëmijët 3 deri në 6 vjeç, të cilat zhvillohen pothuajse tërësisht jashtë, pa marrë parasysh motin. Këto kopshte në natyrë ata i quajnë si “kopshte pyjore” (Forest Kindergarten). Sistemi arsimor danez është i njohur për të metodat inovative të mësimdhënies dhe mësim joformal në mjedise, të cilat promovojnë kreativitet dhe mendim kritik (Bell et al., 2017).

Në Danimarkë zhvillohen tashmë e sa vite kopshtet pyjore të cilat janë dhe kulturë e këtij vendi, në të cilat fëmijët janë të lirshëm në aktivitetet e tyre ku shpeshherë atyre u lejonet të përdorin edhe mjete të vërteta, thika të vërteta (ang. real knives), sharra të vërteta (ang. real saws) dhe ngjitje pemësh (ang. climbing trees). Megjithatë, më e mira e kësaj është që nuk ka kosto të lartë dhe fëmijët kanë hapsirë të jenë të lirshëm në lojën e tyre.

Sipas disa hulumtimeve në Danimarkë, disa prindër preferojnë t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë në mes të pyllit për një arsim të përqendruar në ambientet e mëdha. Në këto kopshte nuk gjendet ndonjë tavolinë ose tabelë e bardhë. Fëmijët janë jashtë gjithë ditës pa marrë parasysh motin, shi, nxehtë ose ftohtë. Këto shkolla pyjore tani janë bërë mjaftë të njohura në shumë vende të botës, ku në Danimarkë një në 10 parashkollor danez tani mbahen jashtë.



Figura 3. Aktivitet në kopshtet pyjore

Sa i përket pyetjes së dytë të këtij punimi “Si ndikojnë metodat inovative në edukimin parashkollor?”, duke u bazuar në të dhënat më lartë, shohim se këto metoda inovative të mësimdhënies kanë një ndikim tejet të rëndësishëm në edukimin parashkollor, pasi që thuhet se stimulojnë kreativitetin tek fëmijët dhe i ndihmon ata të shprehin idetë e tyre, të bëhen më të aftë për jetë dhe punë si dhe të jenë të lirshëm të eksplorojnë, të luajnë dhe shoqërohen. Po ashtu, thuhet se përmes metodave inovative të mësimdhënies fëmijët do të jenë në gjendje të mësojnë dhe mbajnë në mend më mirë atë që u mësohet, pa bërë shumë përpjekje.

Kurse, në lidhje me pyetjen e tretë “A janë të aplikueshme metodat e tilla në vendin tonë?, në bazë të asaj që thuhet në raportin KEEN (2018), shohim se egziston ende një qasje jo serioze ndaj këtij niveli të arsimimit. Po ashtu edhe mungesa e infrastrukturës së përshtatshme për moshën e fëmijëve, mungesa e materialeve didaktike dhe materialeve shpenzuese të cilat nevojiten për organizimin e aktiviteteve janë disa nga çështjet të cilat nuk janë trajtuar mjaftueshëm. Duke pasur parasysh këtë, mund të themi se në vendin tonë mungon edhe aplikimi i metodave inovative për fëmijët parashkollor. Duke u bazuar nga praktikrat e mija studimore, kam hasur të shoh që ka mungesa të shumta të mjeteve dhe materialeve didaktike dhe shpenzuese të cilat janë të nevojshme për organizimin e këtyre aktiviteteve, sidomos të atyre teknologjike. Poashtu, edukatorët kanë ende pasiguri në realizimin e aktiviteteve në ambiente të hapura, veçanërisht në kopshtet pyjore.

4. KONKLUDIME DHE REKOMANDIME

Nga ky punim kuptohet se metodat inovative të mësimdhënies kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin profesional të fëmijëve. Nga shqyrtimi i literaturës shohim se përdorimi i tyre nga ana e edukatoreve, ndihmon shumë në realizimin e procesit mësimor si dhe ndikon pozitivisht në performancën e fëmijëve. Edhe pse metoda tradicionale e mësimdhënies përfshinë disa përparësi të cilat nuk mund ti shmangim, ajo nuk përmbanë në vete shumë risi. Qëllimi i mësimdhënies kërkon gjithnjë të ripërcaktohet në epokën moderne. Në ditët e sotme, fëmijët kërkojnë njohuri përmes aplikimit të metodave inovative, ku mësimi bëhet një proces i gëzueshëm, eksperimentues dhe provokues i mendimit. Në mësimdhënie, aplikimi i metodave inovative ringjallë pasivitetin e fëmijëve. Ata janë më të vëmendshëm dhe të angazhuar, gjë që rezulton në të mësuarit më efektiv se në mësimdhënien tradicionale. Pasi që metodat inovative kanë një ndikim të rëndësishëm në edukimin parashkollor, ato mund të integrohen dhe të aplikohen së bashku me metodat e tjera, varësisht nga nevoja, kushtet, kërkesa dhe dëshira e disponimi i përgjithshëm. Ato mund të modifikohen dhe adoptohen sipas nevojës.

Duke u bazuar në të dhënat që nxorrëm për vlerësimin e metodave tradicionale, bashkëkohore dhe rëndësinë e ndikimit të metodave inovative të mësimdhënies, rekomandimet e mija janë këto:

- Të aplikohen metoda të tilla inovuese në vendin tonë, e veçanërisht ajo në “kopshtet pyjore” pasi që nuk ka një kosto të lartë dhe fëmijët kanë hapsirë të mjaftueshme për eksplorim.
- Qeveria e Kosovës të ndajë fonde për insitucionet parashkollore në mënyrë që institucioni të sigurojë mjetet e nevojshme për aplikimin e këtyre metodave ku do të promovojnë mendimin kritik, kreativitetin, bashkëpunimin dhe kooperimin, si aftësi të rëndësishme të shekullit të 21-të.
- Pasi që metodat tradicionale, bashkëkohore e inovative kanë një ndikim të rëndësishëm në edukimin parashkollor, ato duhet të integrohen dhe të aplikohen së bashku, varësisht nga nevoja, kushtet, kërkesa dhe dëshira e disponimi i përgjithshëm (children´s needs, lacks and wants).

- Edukatorët të trajnohen me praktika dhe njohuri që do të mund t'u përshtaten nevojave të çdo grupmoshe në çdo kohë dhe në çdo vend.

Si përfundim, mund të thuhet se roli i edukatorës në mësimdhënien bashkëkohore është i rëndësishëm sepse ajo orienton, udhëzon dhe ndihmon fëmijët gjatë gjithë procesit mësimor, ndërsa fëmijët përfshihen në mënyrë aktive dhe veprojnë. Kur edukatorja nxit fëmijët të bëjnë pyetje, gjerë sa ajo bisedon, diskuton dhe shkëmben ide gjithashtu edhe fëmiju është më i lirë të bëjë pyetje dhe të kërkojë përgjigje, bile edhe të diskutojë, arsyetojë dhe argumentojë. Vetëm me një edukim të tillë bashkëkohor, fëmiju jeton, rritet dhe zhvillohet në një ambient të përshtatshëm, jokërcënues, me edukatore të trajnuara. Edukatore të tilla janë të afta dhe në gjendje t'i përmbushin të gjitha nevojat e fëmijëve në çdo aspekt: sipas dëshirave të fëmijëve, preferencave, mangësive, por edhe mungesës së njohurive, apo aftësive. Në këtë mënyrë edukatorët do përshtasin, modifikojnë dhe adoptojnë çdo metodë, teknikë dhe mjet mësimor vetëm e vetëm që fëmijët të jenë në hap me kohën.

REFERENCAT

- Bell, N., Zenin, G. & Williams, J.**(2017). Tackling Bullying in Early Childhood: STEM in the early years. *Early Horizons*. The Danish Forest School Approach - ASG. Tërhequr në Tetor 2019 nga: https://www.asg.com.au/doc/default-source/early-horizons/asg_eh_2017_issue_6-1_web_fa.pdf?sfvrsn=2
- Brigham, D.**(2001). Converting Student Support Services to Online Delivery. *International Review of Research in Open and Distance Learning*, 1. Tërhequr në Tetor 2019 nga: <http://www.irrodl.org/index.php/irrodl/>
- Bonk, C.J. & Khoo, E.,** (2014). Aktivitetet për motivimin e fëmijëve. *Open World Books*. Indiana, SHBA. Tërhequr në Shtator 2019 nga: <https://edukimi.uni-gjk.org/upload/dokumentet/31725-Gentiana%20Alaj.pdf>
- Cheetham, G. & Chivers G.,** (2005). Profesionet, kompetencat dhe të mësuarit informal. *Edward Elgar Publishing*. Dallas. Tërhequr në Shtator 2019 nga: <https://edukimi.uni-gjk.org/upload/dokumentet/31725-Gentiana%20Alaj.pdf>
- Choi, B., Jangho, P., Kim, H.R. & Kim, H.W.** (2014). The Effects of a Forest Kindergarten Program on the Sleep Habits of Preschool Children. *Sleep Med Res.* (5) 1: 15 – 19. Tërhequr në Nëntor 2019 nga: https://www.researchgate.net/publication/273445450_The_Effects_of_a_Forest_Kindergarten_Program_on_the_Sleep_Habits_of_Preschool_Children
- Classroom resources,** the Room 241 Team, (2018). Innovation in Education: What Does It Mean, and What Does It Look Like?. *A Blog by Concordia University Portland*. Universiteti Concordia-Portland. Tërhequr në Shtator 2019 nga: <https://education.cu-portland.edu/blog/classroom-resources/educational-innovations-roundup/>
- Damotharan V.S. & Rengarajan, V.** (2006). Inovative Methods of Teaching. One Print, Dhaka, 2006,f.5. Tërhequr në Shtator 2019 nga: https://www.math.arizona.edu/~atpmena/conference/proceedings/Damodharan_Innovative_Methods.pdf

- Davis, L.C.** (2018). Creative Teaching and Teaching Creativity: How to Foster Creativity in the Classroom. *Psych Learning Curve*. American Psychological Associations's. Tërhequr në Nëntor 2019 nga:
<http://psychlearningcurve.org/creative-teaching-and-teaching-creativity-how-to-foster-creativity-in-the-classroom/>
- Garcia, E.** (2014). Innovative Practice: 5 Strategies for the Early Learning Classroom. *Edutopia*. Project – Based Learning. Tërhequr në Tetor 2019 nga:
<https://www.edutopia.org/blog/strategies-for-early-learning-classroom-elizabeth-garcia>
- Gjokutaj, M.**(2009). Didaktika e Gjuhës Shqipe. *SHBLU*. Tiranë, f.2002.
- Kalyani, D. & Rajasekaran, K.** (2018). Innovative Teaching and Learning. *Journal of Applied and Advanced Research*. 3. 23. 10.21839/jaar.2018.v3iS1.162.
 Tërhequr në Gusht 2019 nga:
https://www.researchgate.net/publication/325090377_Innovative_Teaching_and_Learning?fbclid=IëAR0cUym6BK11KjuifJ30K7PDLXkz7knNzigCFm2NKaZuXr6r1I2ivS3Idso
- Kumaravadivelu, B.,** (2006). Understanding language teaching, From method to postmethod, ESL & Applied Linguistics Profesional Series, London, f.83.
 Tërhequr në Korrik 2019 nga: <https://www.academia.edu/>.
- Kuvendi i Kovovës,** (2006). Ligji mbi Edukimin Parashkollor. Ligji Nr. 02/L-52. *Gazeta zyrtare*. Tërhequr në Nëntor 2019 nga:
<http://www.downsyndromekosova.org/wp-content/uploads/2014/07/Ligji-per-edukim-parashkollor1.pdf>.
- Majlinda, GJ., Ema, Rr., Kushtrim, B.,** (2018). KEEN- Kosovo Education and Employment Network. Edukimi Parashkollor në Kosovë, Prishtinë.
 Tërhequr në Gusht 2019 nga: http://keen-ks.net/site/assets/files/1445/edukimi_parashkollor_ne_kosove_alb.pdf
- Musai, B.** (2003). Metodologjia e mësimdhënies. Tiranë: CDE, f. 11.

- Musai, B.** (1999). Psikologji Edukimi: Zhvillimi, të nxënit, mësimdhënia. Tiranë. Fq. 18 – 21.
- QTKA,** (2015). Mësimdhënia me në qendër nxënësin. (1), Geer, Tiranë.
Tërhequr në Nëntor 2019 nga: <https://docplayer.net/95986123-Universiteti-i-gjakoves-fehmi-agani-fakulteti-i-edukimit-gjakove-drejtimi-parashkollor.html>
- Rama, B.** (2011). Metodatat e mësimdhënies dhe ndikimi i tyre në të nxënë. *Revista pedagogjike*”.Tiranë: fq.30.
- Sadiku, A.** (2018). Ligjeratë e autorizuar.
- Saeideh, A., Mohammad, Y. & Keshtiaray, N.** (2015). Methods of Nurturing Creativity during Preschool Term: An Integrative Study. Vol. 11(6), pp.204-210.DOI:0.5897/ERR2015.2305. Tërhequr në Tetor 2019 nga:
https://www.researchgate.net/publication/298334159_Methods_of_nurturing_creativity_during_preschool_term_An_integrative_study
- SEEDS – Social Entrepreneurship Empowering Development in Preschools.** (2019). Innovative Methods in preschool Activities. *Cesie – The world is only one cretaure*. Tërhequr në Korrik 2019 nga: <https://cesie.org/en/news-en/seeds-innovative-methods-in-preschool-activities/>
- Senthilkumar. V., & Kannappa. R.** (2017). Impact of Innovative Teaching and Learning Methodologies for Higher Educational Institutions with Reference to Trichirappalli District. *IOSR- Journal of Business and Management (IOSR-JBM)*. e-ISSN: 2278-487X, p-ISSN: 2319-7668. Volume 19, Issue 7. Ver. II (July 2017), PP 88-92. Tërhequr në Korrik 2019 nga:
<http://www.iosrjournals.org/iosr-jbm/papers/Vol19-issue7/Version-2/M1907028892.pdf>
- Verma, N.** (2017). Different Preschool Teaching Methods & Techniques used worldwide. *Bachpanglobal*. Tërhequr në Tetor 2019 nga:
<https://www.bachpanglobal.com/blog/different-preschool-teaching-methods-techniques-used-worldwide/>

Woolfolk, A. (2011). Psikologjia e Edukimit.CDE.Tiranë, fq.6.

Zylfiu, N. (2004). Didaktika, Prishtinë, f.307.